

SHOQËRIA RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME SHKODËR SH.A

SEKTORI I BURIMEVE NJEREZORE

SHPALLJE PER VENDE TE LIRA PUNE

Bazuar ne Ligjin 7961, date 12.07.1995 “Kodi i Punes i Republikes se Shqiperise” (i ndryshuar), mbështetur në Ligjin nr.9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” të ndryshuar, Vendimit te Këshillit te Ministrave nr. 302, date 11.05.2022 “Politikat Kombëtare për Riorganizimin e Sektorit te Furnizimit me Ujë të Largimit të Ujrave te Ndotura”, Statutit të Shoqërisë Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Qarku Shkodër sh.a. Vendimin Nr.11. datë 06.06.2024 “Për Miratimin e Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të Shoqërisë Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Shkodër sh.a”, Vendimit nr.9 date 18.12.2025, “Keshillit Mbikqyres”, Për miratimin e organigramës dhe nivelit te pagave për punonjësit e Shoqërisë Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Shkodër sh.a, shpallen procedurat e konkurimit per vend te lire pune:

1(nje) Roje /Komandues Vau i Dejes

Detyrat dhe pergjegjesite kryesore

- ✓ Kryejnë shërbimin e manovrimeve sipas grafikut të hartuar nga Përgjegjësi i Degës Dispeçeria dhe të miratuar nga Drejtori apo Administratori, duke u përgjigjur ligjërisht për thyerjen e këtij grafiku dhe ndryshimin e tij pa miratimin e Eprorëve të lartpërmendur.
- ✓ Zbaton me përpikmëri disiplinën në punë dhe në asnjë rast nuk duhet të largohet nga vendi i punës pa u zëvendësuar dhe pa marre miratimin e Përgjegjësit të Degës.
- ✓ Për arsye madhore (sëmundje apo arsye të tjera madhore) mund të largohet nga puna me miratim të Eprorit më të afërt (Përgjegjësit të Turnit etj), i cili menjëherë njofton Përgjegjësin, K/Dispeçerin për zëvendësim të tij. Të gjitha veprimet për njoftim kryhen nga Dispeçeria duke bërë edhe shënimet përkatëse në liber për Urdhrat e dhëna.
- ✓ Marrja në dorëzim e turnit bëhet vetëm me proces-verbal të rregullt, ku pasqyrohen këto procese pune. Gjatë marrjes së turnit në dorëzim manovruesi duhet të njihet me urdhërat e dhëna nga Eprorët gjatë periudhës që ai nuk ka qenë në detyrë dhe duhet ti zbatojë ato me korrektësi.
- ✓ Paraqitet në vendin e punës 10 minuta përpara marrjes së detyrës nga orari i punës së caktuar nga Shoqëria.
- ✓ Mban përgjegjësi dhe përgjigjet për pastërtinë e ambienteve të punës dhe për mos plotësimin e ruajtjen me seriozitet të librit të shërbimit.

Mban përgjegjësi, sipas shkallës së dëmit dhe rrezikshmërisë, për të gjitha veprimet e kryera në kundërshtim me Urdhrat e dhëna nga Eprorët, apo për mos realizimin në afat dhe me cilësi të detyrave të ngarkuara

Kandidatet duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:

- ✓ Te jene shtetas shqiptare .
- ✓ Arsim I ulet ose I mesem.
- ✓ Te jene ne gjendje te mire shendetesore dhe te afte fizikisht.

DOKUMENTACIONI, MENYRA DHE AFATET E DOREZIMIT

1. CV
2. Fotokopje ID
3. Librezë Pune
4. Çertifikatë personale
5. Çertifikatë e gjendjes familjare
6. Diplome shkolle (e noterizuar)
7. Listë notash (e noterizuar)
8. Çertifikatë/ Dokument për kualifikime të ndryshme/Specializime
9. Dëshmi Penaliteti
10. Vertetim i Gjendjes Gjyqësore
11. Vertetim prokurorie
12. Saktësim adrese nga Bashkia
13. Raport Mjekoligjor (Aftësi në punë)
14. Foto të vogla (2 copë), foto e madhe (1 copë)

Afati i aplikimit 10 dite.

Kandidatet do të vlerësohen në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar.

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve , Drejtoria e Burimeve Njerezore do të shpallë fituesit në portalin “ Sherbimi Kombëtar I Punesimit”, në faqen e internetit.

Kandidatet jo fitues kanë të drejtë të ankimohen pranë Drejtorisë së Burimeve Njerezore . Afati i Ankimit është 3 (tre) dite nga data e shpalljes së fituesit.